



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:073710

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05486697

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.292/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Mus Povataj, me pjesëmarrjen të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit S.. GJ.. për shkak të veprës penale Të kanosjes nga neni 181 par. 2 lidhur me par 1 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme sipas aktakuzës PP/II.nr.639/21 të datës 19.04.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë të hapur për publikun me datë 26.02.2024 në prezencë të Prokurores se Shtetit Ardiana Verseli të pandehurit S.. GJ.. dhe mbrojtësi i tije av Agim Muhaxheri sipas autorizimi dhe të dëmtuarit J..F.., të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht ndërsa me datë 21.03.2024 përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

S.. GJ.., i lindur me datën, në fshatin L.. K.. Gj.. ku edhe banon, nga i ati S.. dhe e ëma M.., e vajzërisë R.., i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, posedon numrin e telefonit, i pa dënuar, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më datën 13.03.2021 rreth orës 02:00, në fshatin Z.., K-P..¹, seriozisht kanos personin tjetër me fjalë se do ta privoj nga jeta këtu të dëmtuarën G..R.., në atë mënyrë që: ditën kritike i pandehuri përmes llogarisë ganja_ganja11 ne rrjetin social “Instagram” fillimisht i drejtohet me fjalët “Prano more kurv, ishi jot jam as pot kutjona” e njëjta e ka tentuar që ta thërras po i pandehuri nuk e ka hapur dhe menjëherë ka filluar ti shkruaj me fjalët se „Une njërin e kam kall pa menu dy her, po ty te shkrij krejt”; „Qysh kanë nis njerëzit me te thirr ty po tutna dojnë me ta bë si D.. P... për çka tekë e dëmtuara ishte shkaktuar frikë dhe ankth për jetën dhe sigurinë e sajë.

-me çka ka kryer veprën penale kanosje nga neni 181 par.2 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 7, 17, 20, 38, 39, 43 69,70 dhe 181 par.2 nen par 1 te KPRK-së dhe neni 364 të KPPRK-së, të pandehurit S.. GJ.. i shqipton:

DËNIM ME GJOBË në shumë prej 500,00 € (pesëqind euro), të cilin dënim obligohet i pandehuri ta paguaj në afat prej 2 (dy) muajve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin e mbetur me gjobë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg, ku një ditë burg do të llogaritet 20 euro.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumë prej 80,00 € (tetëdhjetë euro) në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

E dëmtuara G..R.. nga fsh. Z.. K.. P.., udhëzohet për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullte civilë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.292/21 të datës 639/21 ndaj të pandehurës S.. GJ.. për shkak të veprës penale të kanosje nga neni 181 par. 2 lidhur me par 1 të KPRK-së dhe G.. R.. për shkak të veprës penale ngacmim nga neni 182 par 1 të KPRK-së.

Ne seance e shqyrtimit kryesorë të datës 26.02.2024 gjykata ka marr aktvendim me të cilin e ka veçuar procedurën ndaj te pandehurës G..R.., e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme PP/II.nr.639/21 të datës 19.04.2021, për shkak të veprës penale ngacmim nga neni 182 par. 1 të KPRK-së. Procedura e veçuar ndaj te pandehurës G..R.., do të procedohet sipas numrit P.nr.167/24.

Ne shqyrtimin kryesor të datë 26.02.2024 gjykata e ka udhëzuar te pandehurit për të drejtën e tyre për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaroi për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorisë, gjykata është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën dhe nuk kanë nevojë për sqarime shtesë. Me pas gjykata i ka njoftuar te pandehurit për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë.

I pandehuri S.. GJ.. është deklaruar: e pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem, me Vjene keq për rastin i premtoj gjykatës se në te ardhëm nuk do te kryej vepra tjera.

Ne vlerësimin e pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit të Shtetit i cili ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Pasi që i pandehurin e pranoj fajësinë unë mbetem në tersi pran aktakuzës dhe cilësimin juridik dhe i propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, ndërsa me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin i propozoj gjykatës që pranimit të fajësisë të merret si rrethanë lehtësuese.

Mbrojtësi i të pandehurit S.. GJ.. av Agim Muhaxheri deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se në seancën e shqyrtimit kryesor nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 248, janë përmbushur kushtet nga neni 242 par. 2 të KPPRK-së, e duke marr parasysh se aktakuza mbështet në këto: Raporti i policit A.. Sh.. PK# 9016 i datës 16.3.2021, Raporti i Rreshter F.. M... #8996 i datës 16.03.2021, procesverbal mbi intervistimin e të dyshuarit nr.1 S.. GJ.. në polici i datës 17.03.2021, procesverbal mbi intervistimin e të dyshuarit nr.2 G..R.. në polici me datë 17.03.2021 dhe procesverbali mbi marrjen në pyetje të të dëmtuarit J.. Gj.. në polici me datë 18.03.2021. Procesverbal i intervistimit të dëshmitarit e K.. D.. e dhënë pranë stacionit Policor me datë 18.03.2021, Procesverbal i intervistimit të dëshmitarit F.. I. e dhënë në stacionin Policor me datë 18.03.2021.

Në fjalën përfundimtare Prokurori i Shtetit ka deklaruar: i propozoj gjykatës që pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit të merret si rrethanë lehtësuese me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit ndaj të njëjtit.

Mbrojtësi i të pandehurit S.. GJ.. av. Agim Muhaxheri në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: i pandehuri pranimit fajësisë se ka bërë nga vullneti i lire pas konsultimeve të mjaftueshme duke e ditur benefitet dhe pasojat, premtori se nuk do të përsëris vepër të njëjtë apo të ngjashme se veprimet e tij i ka marrë në afekt dhe për atë është përnduar i propozoj gjykatës që ndaj të njëjtit të shqiptohet një dënim sa më i butë apo alternative për faktin se për herë të parë është para gjykatës për vepër të njëjtit apo të kapitullit ku bjen kjo vepër.

I akuzuari në fjalën përfundimtare në shqyrtim kryesor ka deklaruar se: pajtohem me, mbrojtësin tim.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili mbështet në provat në baze të se cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga neni 181 par 2 lidhur par 1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën, gjykata mori pranimin e fajësisë, keqë ardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, me parë nuk ka qenë i dënuar, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata ka gjetur shkallën e lartë të dashjes ne kryerjen e veprës penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar si ne dispozitat te këtij aktgjykimi mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet për paushall gjyqësor në shumë prej 60,00 €, e duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj dhe 20,00 € për taksen për programin për kompensimin e viktimave të krimit,

Komfor nenit 462 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarën e udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2021:073710, 21.03.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

G j y q t a r i,

Edona Berisha Kastrati

Musë POVATAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë ditëve) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.